STUDIO NOTERIALE
NOTERE *MIMOZA SHEHU*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**Notere Mimoza Shehu**
**Nr. 2844 Rep.**

## VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 01.05. 2010 (dymije e dhjete), ne zyren e noterise Tirane perpara, meje Notere Mimoza Shehu me seli ne rrugen "A. Frasheri" u paraqit Z. / Znj. [illegible], identifikuar me nr. pat. / pas. [illegible] e cila / i cili kerkoi vertetimin me origjinalin te dokumentit te emertuar si vijon: [illegible]

Pasi bera verifikimin e dokumentit origjinal vertetohet se fotokopja e dokumentit eshte e njejte me origjinalin.




**NOTERE**
**Mimoza R. Shehu**

STUDIO NOTERIALE
NOTERE Mimoza SHEHU

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR.1012 REP.
NR.3063 KOL.

## MARREVESHJE PER TRANSFERIMIN E KUOTAVE TE KAPITALIT TE SHOQERISE "NATURAL FARMING(NAFA)SH.P.K

Sot ne Tirane me date 15 / 10 /2009(dymije e nente), perpara meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

Shoqeria"**NATURAL FARMING(NAFA)Sh.p.k**,shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne Tirane,Ndroq,Fshati Varosh,Km 12 i rruges Nacionale Tirane-Ndroq ,Kompleksi Blegtoral prane Vila Toskana,identifikuar nga Nipt-i K 82111001T, perfaqesuar rregullisht ne kete marreveshje nga :
**Zj.Silvana Jance** ne cilesine e administratores te shoqerise,e datelindjes 25 Maj 1978,identifikuar nga pasaporta me nr.Z.1096341 dhe
**Z.Gezim Kukaj** me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise, i biri i Shpendit dhe Gjylies,i lindur me 20.03.1961,lindur ne Shkoder dhe banues ne Tirane,madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar,identifikuar nga pasaporta me nr.Z.1790019 (ne vijim "dhuruesi").

**Dhe**

**Z.Artur Dojaka**,i biri i Harunit dhe i Marlenit,dtl.06.06.1970,lindur dhe banues ne Tirane,madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar,identifikuar nga pasaporta me nr.10914362.(ne vijim "pranuesi i dhurimit").

(Referuar ne vijim ne kete marreveshje si "palet")

**MEQENESE:**

a) Dhuruesi zoteron 100% te kapitalit themeltar te shoqerise **NATURAL FARMING(NAFA)Sh.p.k** (ne vijim "Shoqeria"), shoqeri e identifikuar nga Nipt-i K 82111001T, me kapital te rregjistruar prej 100.000(njeqind mije)Leke.
b) Dhuruesi, nepermjet kesaj marreveshje deklaron vullnetin e tij per te transferuar 100 kuota te Shoqerise qe perfaqesojne 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise tek pranuesi i dhurimit;

c) Dhuruesi shpreh vullnetin e tij per te dhuruar 100 kuota qe perfaqesojne 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise;
d) Kapitali i shoqerise perbehet nga kontribute te ortakut te vetem ne te holla dhe ne natyre.

Duke marre parasysh sa me lart, per te cilat palet jane dakort e nuk kane pretendime, bien dakort si vijon:

**NENI I**
**PARASHTRIMET**

1.1 Parashtrimet e mesiperme ne kete Marrevshje perfaqesojne arsyet dhe vullnetin e lire te paleve per sa i perket nenshkrimit te kesaj Marreveshje.

**NENI II**
**OBJEKTI**

2.1 Objekti i kesaj Marreveshje eshte dhurimi i 100 kuotave qe perfaqesojne 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise nga Dhuruesi te pranuesi i dhurimit sipas kushteve vijuese.

**NENI III**

3.1 Me nenshkrimin e kesaj Marreveshje, pranuesi i dhurimit behet titullar i ligjshem i 100 kuotave qe perfaqesojne 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise dhe fitojne te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe lidhen me zoterimin e ketyre kuotave ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e Shoqerise.

**NENI IV**
**GARANCI**

4.1 Dhuruesi deklaron se shoqeria eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e se drejtes shqiptare e themeluar dhe qe ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Shoqeria eshte regjistruar prane te gjitha autoriteteve kompetente ne Republiken e Shqiperise.
4.2 Dhuruesi deklaron se eshte titullar i ligjshem i kuotave, objekt i kesaj Marreveshje dhe gezon te gjithe te drejtat per nenshkrimin e kesaj Marreveshje.
4.3 Dhuruesi deklaron se kuotat e kapitalit te Shoqerise jane te lira nga cdo barre ose pretendim tjeter ligjor i te treteve mbi to.
4.4 Dhuruesi deklaron se Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me te gjitha ligjet dhe aktet e tjera normative ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe se

pranuesi i dhurimit, pas interesimit te tij me Shoqerine, nuk eshte ne dijeni te ndonje fakti apo akti qe mund te kundershtoje kete deklarim;
4.5 Dhuruesi deklaron se gjendja financiare e Shoqerise eshte ne perputhje te plote me deklarimet e kryera ne pasqyrat financiare te Shoqerise dhe se Shoqeria nuk ka detyrime apo marreveshje qe nuk jane te pasqyruara ne pasqyrat financiare dhe librat e Shoqerise te cilat te mund t'i shkaktojne Shoqerise ndonje efekt material negativ. Me efekt material negative do te kuptohet cdo ngjarje e cila rrezikon ose rendon ne menyre thelbesore kryerjen normale te aktivitetit te shoqerise. Te gjitha pasqyrat financiare dhe librat e Shoqerise jane mbajtur ne perputhje me ligjet dhe jane te verteta dhe te rregullta.
4.6 Shoqeria gezon titull ligjor te plote mbi te gjitha asetet e Shoqerise, te cilat pasqyrohen ne Bilanc apo ne menyre tjeter si prone e Shoqerise apo te cilat ne daten e Bilancit jane mbajtur ose perdorur per ushtrimin e aktivitetit dhe Shoqeria i gezon keto te drejta te lira nga cdo lloj barre, kontrata qiraje apo qira financiare, huaje apo Kontrata te tjera te gjitha keto asete jane ne posedim dhe nen kontrollin e Shoqerise.
4.7 Dhuruesi nuk ka detyrime te papaguara kundrejt Shoqerise, dhe nese po, do te paguhen plotesisht para lidhjes se kesaj Marreveshje;
4.8 Dhuruesi deklaron se shoqeria nuk eshte ne proces falimentimi apo likujdimi dhe dhuruesi nuk eshte ne dijeni te procedurave te hapura falimenti apo likujdimi apo te rrethanave te cilat mund te shkaktojne fillimin e ketyre procedurave.

**NENI V**
**TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE**

5.1 Dhuruesi ka marre te gjitha hapat dhe ka marre te gjitha autorizimet nga Shoqeria per miratimin e transferimit te kuotave te kapitalit, objekt i kesaj Marreveshje, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
5.2 Dhuruesi merr persiper dhe garanton pranuesin e dhurimit per rregjistrimin ne emer te Shoqerise te Kontributit ne Natyre dhe te Objekteve te percaktuar ne piken d dhe te parashtrimeve prane ZVRPP Tirane.Per te garantuar zbatimin e kesaj marreveshje palet bien dakort qe Z.Artur Dojaka te pajiset me prokure per te kryer veprimet e transferimit prane QKR-se dhe Z.R.P.Palujtshme ne cdo kohe qe ai e cmon te nevojshme.
5.3 Palet bien dakort te trajtojne si te dhene konfidenciale nenshkrimin e kesaj marreveshje dhe te mos perhapin tek te trete permbajtjen e kushteve te saj pa miratimin me shkrim te pranuesit te dhurimit.

**NENI VI**
**NJOFTIME**

6.1 Per qellim njoftimi ne lidhje me kete Marreveshje, Palet zgjedhin adresat dhe persònat e kontaktit si vijon:

-Dhuruesi:**Shoqeria"NATURALFARMING(NAFA)Sh.p.k**,shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne Tirane,Ndroq,Fshati Varosh,Km 12 i rruges Nacionale Tirane-Ndroq ,Kompleksi Blegtoral prane Vila Toskana,identifikuar nga Nipt-i K 82111001T **,Z.Gezim Kukaj**, ne adrese:Rr'Siri Kodra',nr.256/2 Tirane.

-Pranuesi i Dhurimit **Artur Dojaka** ,Rr'Qemal Stafa'Tirane.

## NENI VII
## TE NDRYSHME

7.1 Kjo marreveshje perben marreveshjen e plote midis paleve dhe zevendeson cdo kontrate te meparshme, marreveshje apo mirekuptim midis paleve mbi keto ceshtje. Asnje shtese apo ndryshim i parashikimeve te kesaj Marreveshje nuk do te jete e detyrueshme per palet, pervecse kur behet me shkrim dhe nenshkruhet rregullisht nga secila pale.

7.2 Te gjitha njoftimet ne lidhje me kete marreveshje do te behen me shkrim dhe do te konsiderohen te njoftuara rregullisht me momentin e marrjes se tyre. Keto njoftime mund te jepen (i)dorazi,(ii)me poste te autorizuara(iii)me sherbim postar qe garanton dorezimin Brenda nje dite pune; ne cdo rast njoftimet kryhen ne adresat perkatese qe palet kane deklaruar ne kete marreveshje.

7.3 Kjo marreveshje nenshkruhet ne 4 kopje ne gjuhen shqipe me vlere te njejte ligjore.

7.4 Kjo marreveshje rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise. Per cdo mosmarreveshje qe mund te linden e lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kesaj marreveshje, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo Marreveshje pasi u lexua, prej meje Noterit me ze dhe Palet e gjejne ne perputhje me vullnetin e tyre te lire te plote, u nenshkrua rregullisht prej tyre ne pranine time dhe une Noteri e vertetoj kete sipas ligjit .

**Dhuruesi**
**Shoqeria'Natural Farming(Nafa) sh.pk.**
**Administratore**
**Silvana Jance**

**Ortaku i vetem i shoqerise**
**Gezim Kukaj**

**Pranuesi i dhurimit**
**Artur Dojaka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

OKR
Qendra Kombëtare e Regjistrimit
National Registration Center

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NIPT) | K82111001T |
| 2. Data e Regjistrimit | 11/09/2008 |
| 3. Emri i Subjektit | "NATURAL FARMING" (NAFA) |
| 4. Forma ligjore | Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar |
| 5. Data e themelimit | 09/09/2008 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 09/09/2008 Deri: |
| 7. Selia | Tirane Ndroq NDROQ Fshati Varosh, Km 12 i rruges Nacionale Tirane-Ndroq, Kompleksi Blegtoral prane Vila Toskana |
| 8. Kapitali | 100.000,00 |
| 9. Numri i pjesëve | 100,00 |
| 9.1 vlera nominale | 1.000,00 |
| 10. Të dhëna mbi shlyerjen e kapitalit | |
| 11. Objekti | Agrobiznes, Kompleks Blegtoral, mbareshtim i gjese se gjalle. Import-Eksport dhe tregtim i gjese se gjalle dhe artikujve bujqesore e blegtorale.Prodhim-Perpunim dhe tregtim te produkteve ushqimore dhe blegtorale.Rritje dhe prodhim shpendesh per veze dhe mish, prodhim dhe tregtim ushqimi per blegtorine si dhe cdo aktivitet tjeter tregtar dhe financiar qe i sherben realizimit te objetivit te saj, etj |
| 12. Përfaqësuesit ligjor | Silvana Jançe |
| Afati i emërimit | Nga: 09/09/2008<br>Deri: 09/08/2013 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

OKR
Qendra Kombëtare e Regjistrimit
National Registration Center

| | |
|---|---|
| 13. Kufizime të kompetencave | |
| 14. Ortakët | Gezim Kukaj |
| Pjesët e zotëruara<br>Përqindja e pjesëmarrjes | 100,00/<br>100,00 |
| 15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Tirane Tirane TIRANE Rruga Pjetër Bogdani, lokal 1 katësh, 50 metra në krah të majtë të kopshtit 31 |
| 16. Të dhëna njoftuar vullnetarisht | Emri Tregëtar: "NATURAL FARMING" (NAFA).<br>Telefon: 0692066162 |
| 17. Statusi | Aktiv |

Datë: 23-06-2009

Emri, Mbiemri
(i nëpunësit të sportelit)